

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
NR. PROT. 943/2
DATE 12.12.2022


REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E AUDITIMIT

Nr. 17302/prot.
3

Tiranë, më 5.12.2022

Lënda: Dërgohet raporti përfundimtar i auditimit.

Z. ARBEN RAKIPI
DREJTOR
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS

Në përfundim të auditimit të kryer në Shkollën e Magjistraturës “Për auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, përputhshmërisë dhe financiar”, ju dërgojmë raportin përfundimtar të auditimit së bashku me planin e veprimit.

Bazuar në nenin 12, gërma d, të ligjit 114 datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, pikës 3 të urdhrit të Ministrit të Financave nr.14, datë 13.02.2017 “Për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm”, brenda 30 ditësh, duhet të hartoni dhe miratoni planin e veprimit për zbatim e rekomandimeve dhe të njoftoni Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Gjithashtu mirëpresim opinionin tuaj, lidhur me punën tonë duke plotësuar formularin e vlerësimit, i cili do të na shërbente për të vlerësuar performancën tonë dhe për të identifikuar fushat ku duhet të përmirësohemi për të qenë të dobishëm për ju dhe të tjerët.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Me respekt,


DREJTOR
Z. Arben Rakipi

PLAN VEPRIMI I SYGJERUAR

PËR REALIZIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT

SUBJEKTI: SHKOLLA E MAGJISTRATURËS

Nr.	Rekomandime	Renditja sipas nivelit.	Referenca e paragraf në raport	Afati i përcaktuar
1	Të përcaktohen në rregulloren e shkollën funksionet e departamenteve të formimit filleshtar, të formimit vazhdues, të kërkimeve shkencore dhe botimeve dhe të sigurohet gjurma e auditimit të veprimtarisë së tyre.	Risku/i mesëm	Faqe 13	Brenda qershor 2023
2	Të hartohet dhe miratohet një formati tip raporti akademik për paraqitjen e rezultateve të veprimtarisë së shkollës.	Risku/i ulët	Faqe 13	Brenda qershor 2023
3	Të merren masa për krijimin e njësisë së dedikuar për funksionet e protokollimit/arkivimit.	Risku/i mesëm	Faqe 19	Brenda qershor 2023
4	Trajtimi financiar i organeve drejtuese të kryhet sipas nenit 5, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblymjet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", i ndryshuar.	Risku/i lartë	Faqe 19	Menjherë
5	Shkolla e Magjistraturës të lidhë marrëveshje regjistrimi për kandidatët fitues të pranuar nga KLGJ dhe KLP, dhe marrëveshje regjistrimi paraprake me kandidatët e shpallur fitues në proces verifikimi të pasurisë dhe figurës, me qëllim trajtimin e barabartë të kandidatëve magjstrat që frekuentojnë rregullisht programin. E drejta e përfitimit financiar të kandidatëve në proces verifikimi, të fillojë në të njëjtën kohë me kandidatët e pranuar, ndërsa ekzekutimi i tij, të kryhet pas pranimit nga KLGJ dhe KLP.	Risku/i lartë	Faqe 33	Menjherë

6 Fondi për pagesë i punonjësve me kontratë (pedagog të jashtëm+ekspertë), të planifikohet dhe të paguhet në artikullin 600 "Paga" dhe 601 "Sigurime shoqërore e shëndetsore"	Rikufi mesëm	Fajqe 55	Në vazhdimësi
--	-----------------	----------	---------------



RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

Objekti i auditimit: Auditimi i sistemeve, përputhshmërisë dhe financiar.

Subjekti i audituar: Shkolla e Magjistraturës

Subjekti auditues: Drejtoria e Auditimit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

I. Përmbledhje ekzekutive

Në zbatim të Ligjit nr. 114, datë 06.11.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, marrëveshjes së bashkëpunimit nr.prot 3308/2, datë 02.03.2022 “Për kryerjen e shërbimit të auditimit” dhe programit të angazhimit të auditimit nr.17302/1, datë 10.10.2022 është kryer një mision auditimi në Shkollën e Magjistraturës për auditimin e sistemit, përputhshmërisë dhe financiar.

Rezultatet e Auditimit:

- Kuadri ligjor-rregullator i Shkollës Magjistraturës është i plotë dhe i përgjigjet misionit të saj.
- Procedurat e informimit dhe komunikimit garantojnë sigurinë që informacioni merret nga të gjitha burimet, duke përfshirë edhe burime të brendshme dhe të jashtme, sigurinë që proceset janë krijuar për t’ia komunikuar informacionin e nevojshëm të gjithë stafit.
- Shkolla ka të rinovuar faqen e saj zyrtare ëeb ku paraqet në vazhdimësi komunikime të ndryshme për palët e interesuara dhe publikun e gjerë, çka tregon nivel të lartë të transparencës nga pikëpamja e informimit dhe llogaridhënies.
- Ecuria e veprimtarisë së shkollës, rezultatet, të dhënat ka nevojë që të jepen të bazuara sipas një formati raporti tip të standartizuar.
- Nuk janë të përfshira në rregulloren e brendshme të shkollës funksionet e departamentit të formimit fillestar, departamentit të formimit vazhdues, departamentit të kërkimeve shkencore dhe botimeve dhe mungon gjurma e auditimit të veprimtarisë së tyre.
- Funkzioni i sekretariatit të Këshillit Drejtues, Këshillit Pedagogjik dhe Komisionit Disiplinor, nuk është përcaktuar në strukturën organizative çka ka sjellë mangësi në administrimin e dokumentacionit të mbledhjeve dhe veprimtarisë të organeve kolegjiale.
- KD i shkollës ka funksionuar dhe është mbledhur sipas nevojave të institucionit dhe ka realizuar funksionet që i jep ligji, për periudhën objekt auditimi.
- Referuar bazës ligjore në fuqi trajtimi financiar i organeve drejtuese nuk është bërë sipas ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj.
- Subjekteve të rivlerësimit *ex officio* që kanë marrë më pak se 60 pikë në fazën e parë të provimit scantron nuk janë shpallur fitues, pavarësisht pikëve që kanë marrë në fazën e dytë të provimit edhe pse në rregulloren e shkollës ishte përcaktuar se rezultati i pikëve të kësaj faze nuk kishte karakter skualifikues

- Shkolla si autoriteti kontraktor ka përgatitur rregjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për periudhën objekt auditimi dhe e ka dërguar në APP dhe në Degën e Thesarit.
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik për vitet 2019-2022 është ndryshuar nga 5-9 herë brenda vitit me arsyetimin për shkak të nevojave të institucionit, ndryshimet konsistojnë në ulje dhe shtesa të fondit limit të prokurimeve të planit fillestar dhe shtimin e nevojave të reja.
- Përqindja e mosrealizimit të buxhetit të planit fillestar të prokurimit krahasuar me faktin për vitet 2019, 2020, 2021 rezulton përkatësisht 20%, 35%, 36% më pak.
- Referuar kontratave në total të prokuruar për vitet 2019, 2020, 2021 çmimi i lidhjes së kontratave rezulton 35%, 47%, 30 % më pak se fondi limit.
- Për periudhën objekt auditimi viti 2019 - 2021, nga dega e financës janë kryer veprimet kontabile në kartelat e llogarive përkatëse për përpilimin e pasqyrave financiare për çdo vit financiar.
- Veprimet kontabile janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ku për çdo regjistrim është bërë në bazë të dokumentave justifikuese, si dhe janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit.
- Për çdo vit kalendarik janë hartuar pasqyrat financiare dhe pas miratimit nga KD brenda afateve të përcaktuara ligjore brenda muajit mars të çdo viti kalendarik ato janë dorëzuar në degën e thesarit Tiranë.
- Rregjistrimi i aktiveve është kryer konformë Kreut III, “Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

dhe si është parashikuar në pikën 4 të nenit 165 të ligjit 96/2016 ku referon se kandidatët të cilët kanë arritur të paktën 60 për qind të pikëve të testit të aftësive profesionale kanë të drejtë të ndjekin programin në Shkollën e Magjistraturës.

- Rezulton se procesi i verifikimit të pasurisë dhe të figurës së kandidatëve magjistrat fitues për vitet akademike 2019, 2020, 2021, 2022 nuk është përmbyllur në asnjë rast nga KLGJ dhe KLP brenda muajit shtator të fillimit të vitit akademik, këto vonesa janë bërë shkak për cënimin e funksionimit normal të veprimtarisë së shkollës magjistraturës.
- Kandidatët për magjistratë, kandidatët për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë fitues, për të cilët nuk është përfunduar procesi i verifikimit të pasurisë dhe të figurës brenda muajit shtator, kanë ndjekur procesin mësimdhënës por nuk kanë nënshkruar marrëveshjen e regjistrimit, e cila parashikon të drejtat dhe përgjegjësitë e kandidatit përgjatë Programit të Formimit Fillestar.
- Kandidatët fitues nuk kanë gëzuar të drejtat dhe detyrimet e formimit fillestar përveç ndjekjes së procesit mësimor deri në momentin e verifikimit.
- Ka raste të kandidatëve fitues që kanë ndjekur procesin mësimor ku procesi i verifikimit të pasurisë dhe të figurës është realizuar pas përfundimit të vitit akademik dhe nuk kanë marrë pjesë në provime, por detyrimet e provimeve i kanë dhënë në sezona të posaçme.
- Ka raste të kandidatëve fitues që nuk kanë ndjekur vitin akademik që janë shpallur fitues dhe u është lejuar të ndjekin vitin akademik pasardhës.
- Kandidatët, gjatë periudhës së ndjekjes së programit të formimit fillestar, kanë përfituar bursën e shkollimit nga momenti i realizimit të verifikimit të pasurisë dhe të figurës edhe pse kanë plotësuar detyrimet e ndjekjes së procesit mësimor.
- Shkolla e Magjistraturës në përputhje me objektivat e ligjit ka analizuar nevojat për trajnim, zhvillimin e kurrikulave dhe programeve trajnuese dhe ka realizuar programet e formimit vazhdues për vitet akademike objekt auditimi. Për periudhën tetor 2018-korrik 2021 janë realizuar në total 528 trajnime dhe janë frekuentuar nga 3119 gjyqtarë dhe 2175 prokurorë.
- Në zbatim të zbatimit të Udhëzimit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, është kryer rakordimi mujor i shpenzimeve, rakordimi mujor i të ardhurave.
- Nëpunësi autorizues, ka paraqitur tek Nepunësi i parë autorizues, raportet e monitorimit të zbatimit të Buxhetit për performancën financiare, konformë Udhëzimit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”.
- Për periudhën objekt auditimi, ka patur rialokime dhe ndryshime të fondeve nga plani fillestar brenda buxheteve vjetore të miratuara, në artikujt 600, 601, 602 dhe 606.
- Referuar zërit buxhetor (artikulli 602 “Mallra dhe shërbime”) planifikimi ka rezultuar çdo vit me tepriçë, më pas plani është ulur gjatë vitit buxhetor. Edhe pas rialokimit ka rezultuar në mosrealizim.
- Fondi i pagave të punonjësve me kontratë (Pedagog të jashtëm+Ekspertë), planifikohet në artikullin 602 “Mallra e Shërbime të tjera” dhe më pas është bërë kalimi i këtij fondi nga llogaria 602 “Mallra e Shërbime të tjera”, në llogarin 600 “Paga”, dhe 601 “Sigurime shoqërore e shëndetsore”.
- Të ardhurat, që janë realizuar, nga shkolla e magjistraturës, janë derdhur në llogarinë e buxhetit të shtetit, që administrohet nga dega e thesarit sipas përcaktimeve të VKM-së, nr.432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijonë Institucionet Buxhetore” dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrisë Financave dhe Shkollës së Magjistraturës.
- Për fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë bërë ndalesat e kontributeve të detyrueshme dhe ndalesat e tatimit mbi të ardhurat.